

VENDIM
Nr. 549, datë 13.6.2013

**PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË ISH-OBJEKTEVE USHTARAKE NË ISH-KOMANDËN
E FORCAVE DETARE (REPARTI USHTARAK NR. 2001),
NË LAPRAKË, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11, 14 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ish-objektet ushtarake në ish-Komandën e Forcave Detare (reparti ushtarak nr. 2001), në Laprakë, Tiranë, sipas listës, t'i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimin në favor të banorëve të pastrehë, të cilët banojnë në këto objekte, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të bëjë kalimin në pronësi të këtyre objekteve për banorët e pastrehë, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave, Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E ISH-OBJEKTEVE USHTARAKE NË ISH-KOMANDËN E FORCAVE DETARE (REPARTI
USHTARAK NR. 2001), NË LAPRAKË, TIRANË**

- OBJEKTI NR. 1- TRUPROJË
- OBJEKTI NR. 2- MENSË- KUZHINË NR. 1
- OBJEKTI NR. 3- MENSË- KUZHINË NR. 2
- OBJEKTI NR. 4- BANJË
- OBJEKTI NR. 5- ZDRUKTHËTARI
- OBJEKTI NR. 6- VEND TAKIMI
- OBJEKTI NR. 7- PARK AUTO DHE DEPO TEKNIKE

Lista emërore e kryefamiljarëve (ushtarë aktivë e në rezervë) që janë trajtuar me banesë në ish-objekte ushtarake në ish-Komandën e Forcave Detare (Reparti Ushtarak nr. 2001), në Laprakë, Tiranë në vitin 1997 dhe që nuk i kanë privatizuar akoma.

- 1. Bislim Berisha
- 2. Shkëlqim Margjeka
- 3. Nuredin Hasanaj
- 4. Përparim Gega
- 5. Ardian Elezi
- 6. Liman Hoxha
- 7. Genci Shehi
- 8. Haxhi Sala
- 9. Xhuljeta Merko
- 10. Roland Hyskolli
- 11. Ardian Dautaj
- 12. Bujar Gjoka
- 13. Dashnor Beta
- 14. Pajtim Bardhi

15. Afrim Bundo
16. Kujtim Dashi
17. Besim Margjeka
18. Izmir Bako

LISTA E OBJEKTEVE ME TË DHËNAT E BANESAVE

Emërtimi i objekteve	Viti i ndërtimit	Vlera fillestare (000/lekë)	Sip. e ndërtimit e përshtatur
Mensë kuzhinë nr. 1	1927	126	780.56
Mensë kuzhinë nr. 2	1927	48	448.0
Zdrukthëtari	1975	13	134.5
Park auto	1962	15	166.66
Depo teknike	1972	8	82.5
Truprojë	1972	26	108.4
Banjë	1972	10	128
Pikë takimi	1970	12	115

Lista emërore e ushtarakëve të trajtuar me objektet përkatëse

Objekti nr. 2 (mensë-kuzhinë nr. 1)

1. Shkëlqim Margjeka Policia Ushtarake
2. Nuredin Hasanaj DR. ORG. në MM
3. Bislim Berisha Flota (FMD)
4. Izmir Bako Br. “KOMANDO”
5. Liman Hoxha Br. “KOMANDO”
6. Ardian Dautaj Flota (FMD)
7. Xhuljeta Merko Flota (FMD)
8. Roland Hyskolli Flota (FMD)

Objekti nr. 5 (zdrukthëtari)

1. Dashnor Beta Br. “KOMANDO”

Objekti nr. 3 (mensë-kuzhinë nr. 2)

1. Haxhi Sala Bat. Sigurimit
2. Bujar Gjoka Flota (FMD)
3. Besim Margjeka Flota (FMD)

Objekti nr. 4 (banjë)

1. Genci Shehi Flota (FMD)

Objekti nr. 6 (vend takimi)

1. Përparim Gega MM

Objekti nr. 1 (truprojë)

1. Ardian Elezi FMA

Objekti nr. 7 (park auto dhe depo teknike)

1. Pajtim Bardhi Flota (FMD)
2. Afrim Bundo Flota (FMD)
3. Kujtim Dashi Flota (FMD)